

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.(H.) Rr., nga fshati B., Komuna e P., për shkak se ka kryer veprat penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5431/18 të dt.22.11.2018, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 15.01.2019, në praninë e Prokurorit të Zef Prendrecaj dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë **15.01.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N.RR., nga i ati H. dhe nëna Sh., e vajzërisë O., i lindur me *data e lindjes...*, nga fshati B., Komuna e P., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal *numri personal...*, Shqitar – Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 16.09.2018, rreth orës 18:00, në rrugën lokale P. – fsh.B., në udhëkryqin në mes të fshatrave B.-S., derisa i pandehuri ishte duke e drejtuar automjetin e tipit “VW Golf 4”, ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit *target e regjistrimit...*, nga pakujdesia duke menduar lehtë se në atë mënyrë nuk do të rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit duke vepruar në kundërshtim me nenin 41 të LRRTRR-së, i cili ka filluar të ç`kqyret në udhëkryq nga krahu i majtë, pa u bindur mirë se me një veprim të tillë mund të rrezikoj pjesëmarrësit në komunikacion, duke mos i dhënë përparësi krahut të djathtë, ashtu që me pjesën e përparme të anës së majtë e godet në pjesën e pasme të anës së djathtë veturën e tipit “VW Golf 3”, ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit *target e regjistrimit...*, të cilën e drejtonte tani e dëmtuara H.M., me ç`rast lëndime të lehta trupore kanë pësuar tani e dëmtuara H.M., L.M. dhe L.M., me pasoja të përkohshme për shëndetin dhe është shkaktuar dëm material.-

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 17, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 358 par.1 lidhur me nenin 31, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463 të KPPPK-së,

G J Y K O N

Të akuzuarin **N.Rr., me dënim me kusht**, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumën prej **(250€ dyqind e pesëdhjetë/euro)**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej **1(një) viti**, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën **40.88€** për ekspertizë të komunikacionit, ndërsa shumën prej **50.00€** për ekspertizën mjeko ligjore, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **20.00€**, në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej **30.00€**, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Të dëmtuarit: H.M., L.M. dhe L.M., nga fshati B., Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.5431/18 të dt.22.11.2018, kundër të akuzuarit N.(H.) Rr., nga fshati B., Komuna e P., për shkak të veprave penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë edhe pse kam menduar se nuk jam fajtor, mirpo në bazë të ekspertizave të ekspertëve unë po e pranoj dhe nuk dua të shkoj më lart për këtë, ky rast ka ndodhur nga pakujdesia, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë, bashkëshorten e kam të sëmurë prej zemrës e operuar dhe me terapi për këtë edhe kam bërë kundërshtimin, ngase nuk kam mundësi për ta paguar, lus gjykatën që ti ketë parasysh të gjitha këto rrethana, duke i premtuar që do të jem më i kujdesshëm.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që ky pranim është bërë me vullnetin e tij të plotë konform dispozitave ligjore.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikimi i

trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor është marrë, konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil, është marrë, në bazë të nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.724/2018, dt.15.01.2019

Sekretarja juridike

Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues

Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.